



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE
DIVIZIONI TEKNIK
DREJTORIA MINERARE

Pyetja nr. 1

Vendimin e plotë të revokimit të lejes minerare ndaj kompanisë “ALKO IMPEX CONSTRUCTION (Ish KLEDOR ALBANIA-09)”.

Përgjigje:

Referuar të dhënave që disponojmë dhe informacionit nga faqja zyrtare e QKB, subjekti “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” shpk me numër NIPT: K91628013D, ka aplikuar për tu pajisur me leje minerare në zonën nr.338/1, objekti Damësi, Bashkia Mallakastër për shfrytëzimin e mineralit gëlqeror. Me shkresën e MIE nr.487/2 prot., datë 15.01.2024 shoqëria është njoftuar për të kryer pagesat për Garancitë Financiare për Akt-Miratimin Nr.1961.

Për arsye se subjekti nuk paraqiti pagesën e garancive financiare në QKB, brënda afatit ligjor të parashikuar në Pikën 6 të Vendimit nr.741 datë 09.09.2015 “*Për miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjes të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e investimit në veprimtarinë minerare*”, subjekti nuk u pajis me leje minerare për këtë zonë.

Pyetja nr.

Vendimin e plotë të revokimit të lejes minerare ndaj kompanisë “ALKO-IMPEX General Construcion”.

Përgjigje:

Referuar të dhënave që disponojmë dhe informacionit nga faqja zyrtare e QKB, shoqëria “ALKO-IMPEX General Construcion” shpk me numër NIPT: K91326028I, ka qënë zotëruese e lejes minerare nr.1939 datë 02.11.2022, objekti “Zall-Herr”, Bashkia Tiranë, dhënë për shfrytëzimin e mineralit Gëlqeror.

Sikurse ju kemi informuar dhe më parë, kjo leje minerare me shkresën e MIE **nr.1490/2 prot., datë 31.05.2025** është revokuar. (dokumenti bashkëlidhur)

Pyetja nr. 3

Vendimin e plotë të revokimit të lejes minerare ndaj kompanisë “M. C. INERTE” me numër nipti “J82020003H”.

Përgjigje:

Referuar të dhënave të dërguara nga ju për shoqërinë “M. C. INERTE” me numër NIPT: J82020003H, nuk disponojmë informacion.

Nëse do të keni ndonjë të dhënë tjetër plotësuese për këtë shoqëri (*si psh. numër leje minerare, datën e lejes, koordinata të lejes, etj*) na i dërgoni, pasi na ndihmojnë në zgjerimin e kërkimeve në të dhënat që disponojmë.

Faleminderit për mirëkuptimin,

**DIVIZIONI TEKNIK
DREJTORIA MINERARE**